

## VENDIM

Nr.1497, datë 19.11.2008

### PËR SHTYPJEN E LETRAVE ME VLERË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

### VENDOSI:

1. Shtypja e letrave me vlerë realizohet nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë, sh.a, me kapital shtetëror, në varësi të Ministrit të Financave.

Kur Shtypshkronja e Letrave me Vlerë nuk ka kapacitet teknologjik për shtypjen e biletave të lojërave të fatit ato mund të shtypen në shtypshkronja brenda ose jashtë vendit, sipas një procedure të përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

Me pamundësi të kapacitetit teknologjik nënkuptohet mungesa e software-ve dhe hardware-ve të nevojshëm për shtypjen e biletave të lojërave të fatit. Me marrjen e kërkesës për shtypjen e biletave të lojërave të fatit, për të cilat Shtypshkronja e Letrave me Vlerë dyshon se nuk ka kapacitetin e duhur teknologjik të shtypjes, ajo mbledh bordin drejtues, i cili analizon ekonomisht në mënyrë të hollësishme, pamundësinë e shtypjes së këtyre biletave dhe argumenton pamundësinë e kthimit ekonomik, nëse do të investohej për blerjen e teknologjisë së munguar për këto raste. Në përfundim, bordi drejtues i Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë merr vendim për pamundësinë e ofrimit të shërbimit, i cili i komunikohet operatorit kërkuar. Në vijim, operatori mund të procedojë me nënshkrimin e kontratës për shtypjen e këtyre biletave në shtypshkronja të akredituara, brenda ose jashtë vendit, dhe vë në dijeni institucionin mbikëqyrës të aktivitetit të tij.

(Ndryshuar me VKM Nr. 475, datë 25.7.2012. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 112, date 25.7.2012).

2. Letra me vlerë, në kuptim të këtij vendimi, do të vlerësohen pullat fiskale, biletat e transportit rrugor dhe hekurudhor . si dhe diplomat e maturës shtetërore, bileta, procesverbale, akte kontrolli, vendim për kundërvajtjen administrative, procesverbal i konstatimit të kundërvajtjes administrative, akt verifikimi, vendim dënimi, vërtetim transporti, bileta për hyrje në zonat e mbrojtura/parqe kombëtare për invalidë dhe automjete, fatura, raporte mjekësore, receta me rimbursim 100%, receta me rimbursim të pjesshëm, receta pa rimbursim, formularë vizite, formularët e procedurave mjekësore, rekomandime, kartela, libreza shëndetësore të lëshuara

nga institucione shtetërore, si dhe dokumente të prodhuara e të lëshuara nga njësitë e qeverisjes vendore, të cilat përmbajnë numër serial.

(Ndryshuar me VKM Nr.277, datë 06.04.2011. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.56, datë 06.04.2011).

(Ndryshuar me VKM Nr.393, datë 18.06.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.98, datë 27.06.2014).

3. Procedurat, afatet dhe çështje të tjera, që lidhen me prodhimin e letrave me vlerë, rregullohen me udhëzimin e Ministrit të Financave që do të dalë brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

4. Vendimet nr.402, datë 6.8.1993 "Për shtypjen e letrave me vlerë", dhe nr.183, datë 28.3.2007 "Për organizimin, shtypjen dhe emetimin e biletave të transportit rrugor" të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare .

**KRYEMINISTRI**

**Sali Berisha**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Edi Rama**

Ndryshuar me VKM Nr. 475, datë 25.7.2012. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 112, datë 25.7.2012.

Ndryshuar me VKM Nr. 277, datë 25.7.2012. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.56, datë 06.04.2011.

Ndryshuar me VKM Nr. 393, datë 18.06.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.98, datë 27.06.2014.

